

INFORMACION I PERGJITHSHEM RRETH PSSA

Cilat shkolla marrin pjesë?

Të gjitha shkollat e Drejtorisë Arsimore marrin pjesë në testimet e vlerësimit. Shkollat jopublike dhe private gjithashtu mund të marrin pjesë mbi baza vullnetare.

Cilët nxënës i nënshtrohen këtij vlerësimi?

Me përjashtim të pak nxënësve, që përmbushin disa kritere specifike, të gjithë nxënësit do të përfshihen në këto vlerësime si më poshtë:

Lexim & Matematikë – Klasat 3, 4, 5, 6, 7, 8, dhe 11

Shkrim – Klasat 5, 8, dhe 11

Shkencë – Klasat 4, 8, dhe 11

Kush vendos se çfarë duhet të vlerësojë ky testim?

Grupe mësuesish nga të gjitha nivelet e arsimit në Pensilvani zgjedhin fushat e njohurive mbi të cilat do të bazohen këto vlerësime. Në këto grupe u përfshin mësues, metodistë, drejtues të kurikulës dhe specialistë të kolegjeve. Po këto grupe rishikuan, redaktuan dhe aprovuan pyetjet e testit.

Kush i administron testimet për këto vlerësime?

Çdo shkollë zgjedh personin(at) e vet, të cilët do të administrojnë testin. Në shumicën e rasteve, këta janë mësuesit e shkollës, të cilët shpesh ndihmohen nga drejtori i shkollës ose një këshilltar drejtues i vlerësimeve.

Si bëhet raportimi i rezultateve?

Dy kopje të raporteve individuale të të gjitha testeve të çdo nxënësi dërgohen në drejtorinë arsimore dhe shkollat çarter për t'u shpërndarë prindërve, mësuesve, këshilltarëve udhëheqës të këtyre testeve, si edhe/ose drejtorëve. Shteti nuk merr ndonjë raport me emrat e individëve pjesëmarrës në testet e vlerësimit. Rezultatet raportohen sipas shkollave, për arsye të analizave të planeve dhe programeve mësimore. Drejtorinë arsimore dhe shkollat çarter mund të botojnë rezultatet e vlerësimit të testit PSSA për secilën shkollë. Shteti gjithashtu nxjerr të dhënat e vlerësimeve për çdo shkollë.

A mund t'i shikojnë prindërit rezultatet e vlerësimeve?

Prindërit dhe kujdestarët mund të rishikojnë vlerësimet duke planifikuar një takim me koordinatorin e vlerësimeve të shkollës, me të arritur këto rezultate në shkollë. Kopje të vlerësimeve ose shënime rreth pyetjeve nuk lejohet të dalin jashtë shkolle pa leje dhe gjithashtu midis palëve nënshkruhet një marrëveshje besimi.

Nëse, pasi është bërë rishikimi i vlerësimeve, prindërit, të cilët nuk do të duan që fëmija e tyre të marrë pjesë në testimet e vlerësimit të leximit dhe matematikës, për arsye besimi fetar, ata mund të dërgojnë një shënim me shkrim shefit të rajonit të drejtorisë arsimore, përpara se të fillojë administrimi i këtij vlerësimi, për të justifikuar mos pjesëmarrjen në këto vlerësime.

INFORMACION RRETH TESTIMEVE NE LEXIM & MATEMATIKE

(klasat 3, 4, 5, 6, 7, 8, dhe 11)

Sa është kohëzgjatja e këtyre testimeve?

Kohëzgjatja e plotë e testimit në lëndët e leximit dhe matematikës është afërsisht nga gjashtë deri në shtatë orë. Drejtoria arsimore duhet t'ju informojë mbi planifikimin e datës së kryerjes së këtyre vlerësimeve.

Ç farë përfshihet në testet e vlerësimit?

Çdo nxënës përfundon tre seksione me pyetje për secilin testim në lëndët e leximit dhe matematikës. Disa nga këto seksione me pyetje do të jenë të njëjta për të gjithë nxënësit dhe disa seksione do të konsistojnë me grupe ushtrimesh të ndryshme.

Ç farë lloje pyetjesh përfshihen në testimet e vlerësimit?

Nxënësit u përgjigjen dy lloje pyetjesh: pyetje me zgjedhje (*multiple choice*) dhe pyetje që kërkojnë zhvillim/shpjegim (*open ended*). Në pyetjet me zgjedhje, përgjigja e saktë zgjidhet nga katër opsionet e paraqitura, ndërsa pyetjet me zhvillim kërkojnë nga nxënësit të shpjegojnë përgjigjet e tyre.

Si bëhet vlerësimi i pikëve për përgjigjet me shkrim të pyetjeve me zhvillim?

Përgjigjet me shkrim për pyetjet me zhvillim në lëndët e leximit dhe matematikës bëhet nga vlerësues që janë trajnuar në zbatimin e një sistemi vlerësimi të paracaktuar më parë. Në lëndët e leximit dhe matematikës, pikët bazohen vetëm në përmbajtje. Drejtshkrimi dhe shenjat e pikësimit nuk përfshihen në procesin e sistemit të vlerësimit.

Ç farë vlerësohet në lëndën e leximit?

Vlerësimi në lëndën e leximit përfshin dy kategori kryesore që përmbledhin procesin e leximit. Nxënësit lexojnë një numër fragmentesh nga të dyja llojet e zhanreve, letërsi e mirëfilltë artistike dhe ajo fantastike shkencore dhe u përgjigjen pyetjeve rreth këtyre fragmenteve. Duke iu përgjigjur këtyre pyetjeve, nxënësit tregojnë aftësitë e tyre në leximin dhe kuptimin e fragmentit, si dhe në bërjen e analizave dhe interpretimin e një teksti artistik dhe fantastik shkencor.

Ç farë vlerësohet në lëndën e matematikës?


Vlerësimi në lëndën e matematikës përfshin pesë kategori kryesore. Proporcioni i pyetjeve për secilën kategori ndryshon sipas klasave/viteve. Si pjesë e vlerësimit të kategorisë A, *Numrat dhe Operacionet me numra*, nxënësit u përgjigjen një seksioni të veçantë pyetjesh, në të cilën përdorimi i kalkulatorit nuk lejohet. Pyetjet që kërkojnë zhvillim/shpjegim, kërkojnë që nxënësit të tregojnë të gjithë punën matematikore (logaritjet, grafikët, vizatimet e të tjera) dhe të shpjegojnë me shkrim të gjithë rrugën e zgjidhjes së problemit.

Informacion për Prindërit ose Kujdestarët Sistemi i Vlerësimit të Shkollave të Pensilvanisë (PSSA)

Vlerësimi në Lexim & Matematikë, 12 – 23, Mars 2012

Vlerësimi në Shkrim, 16 – 20 Prill, 2012

Vlerësimi në Shkencë, 23 – 27 Prill, 2012



INFORMACION RRETH TESTIMEVE NE SHKRIM (klasat 5, 8, dhe 11)

Sa është kohëzgjatja e këtyre testeve?

Kohëzgjatja e plotë e testimit në lëndën e shkrimit është afërsisht nga katër deri në gjashtë orë. Drejtoria arsimore dot'ju informojë mbi planifikimin e datës së kryerjes së këtyre testeve.

Ç farë përfshihet në testet e vlerësimit?

Vlerësimi në shkrim konsiston në 22 pyetje që kërkojnë përgjigje me zgjedhje dhe 3 pyetje që kërkojnë zhvillim me shkrim. Disa pjesë të testimit do të jenë të njëjta njëjta për të gjithë nxënësit dhe disa do të përbëhen nga grupe të ndryshme pyetjesh. Të gjitha pjesët do të shkruhen në përputhje me Standardin Akademik të Pensilvanisë për Shkrimin.

Ç farë lloje pyetjesh përfshihen në testimet e vlerësimit?

Nxënësit u përgjigjen dy lloje pyetjesh: pyetje me zgjedhje (*multiple choice*) dhe pyetje që kërkojnë zhvillim/shpjegim (*open ended*). Në pyetjet me zgjedhje, përgjigja e saktë zgjidhet nga katër opsionet e paraqitura, ndërsa pyetjet me zhvillim kërkojnë nga nxënësit të shpjegojnë përgjigjet e tyre.

Si bëhet vlerësimi i pikëve për përgjigjet me shkrim të pyetjeve me zhvillim?

Vlerësues të trajnuar japin pikët për përgjigjet e nxënësve në kompozim (fokusi, zhvillimi i përmbajtjes, organizimi dhe stili) duke përdorur kritere vlerësimi të miratuara. Më tej, një grup i dytë vlerësimi jep pikët e përgjigjes të nxënësit për anën konvencionale (formimi i fjalisë, gramatika, përdorimi, rrokëzimi dhe shënjat e pikësimit). Pikët e kompozimit dhe ato konvencionale kombinohen për të përcaktuar nivelin e aftësisë të nxënësit.

Ç farë vlerësohet në lëndën e Shkrimit?

Vlerësimi në shkrim, ofron një matës të drejtpërdrejtë të aftësisë të nxënësit për të zhvilluar, organizuar dhe shprehur idetë e tyre me shkrim. Ky testim ka si qëllim vlerësimin e performancës të nxënësit, të ofrojë të dhëna për programin shkollor në lëndën e shkrimit dhe të shërbejë, si tregues i vlerësimeve për shkollat lokale në këtë lëndë.

INFORMACION RRETH TESTIMEVE NE SHKENCE (klasat 4, 8, dhe 11)

Sa është kohëzgjatja e këtyre testeve?

Kohëzgjatja e plotë e testimit në lëndën e shkencës është afërsisht nga dy deri në katër orë. Drejtoria arsimore do t'ju informojë mbi planifikimin e datës së kryerjes së këtyre testeve.

Ç farë përfshihet në testet e vlerësimit?

Nxënësit në klasat 4 dhe 8 plotësojnë dy seksione për vlerësimet në shkencë; nxënësit e klasës 11 plotësojnë tre seksione. Disa pjesë të testimit do të jenë të njëjta për të gjithë nxënësit dhe disa do të përbëhen nga grupe të ndryshme pyetjesh.

Ç farë lloje pyetjesh përfshihen në testimet e vlerësimit?

Nxënësit u përgjigjen dy lloje pyetjesh: pyetje me zgjedhje dhe pyetje që kërkojnë zhvillim/shpjegim. Në pyetjet me zgjedhje, përgjigja e saktë zgjidhet nga katër opsionet e paraqitura, ndërsa pyetjet me zhvillim kërkojnë nga nxënësit të kompozojnë përgjigjet e tyre. Për nxënësit e klasave 8 dhe 11, vlerësimi përfshin gjithashtu edhe skenarë shkencorë

Ç farë është një skenar në shkencë?

Një skenar shkencor përfshin tekste, grafikë, diagrama dhe/ose tabela dhe i përdor këta elementë për përshkrimin e rezultatit të një projekti të klasës, një eksperimenti, ose një kërkimi të ngjashëm shkencor. Nxënësit përdorin informacionin e marrë në skenarin shkencor për përgjigjet e pyetjeve me zgjedhje (klasat 8-11) dhe atyre me zhvillim (vetë klasa 11).

Si bëhet vlerësimi i pikëve për përgjigjet me shkrim të pyetjeve me zhvillim?

Përgjigjet me shkrim për pyetjet me zhvillim në lëndën e shkencës bëhen nga vlerësues që janë trajnuar në zbatimin e një sistemi vlerësimi të paracaktuar më parë. Në shkencë, pikët bazohen vetëm në përmbajtje. Drejtshkrimi dhe shenjat e pikësimit nuk përfshihen në procesin e sistemit të vlerësimit.

Ç farë vlerësohet në lëndën e Shkencës?

Testimi në shkencë adresohet në katër kategori kryesore: Natyra e Shkencës, Shkencat Biologjike, Shkencat Fizike dhe Shkencat e Tokës dhe Hapsirës. Proporcioni i pyetjeve të secilës kategori, varion sipas nivelit të klasave. Secila kategori përfshin disa Pika bazë Vlerësimi dhe Përmbledhje të Vlefshme.